

Qytetarët i besojnë më shumë AMF-së në zgjidhjen e problematikave të tyre

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2018
- Ecuria e numrit të kontratave të sigurimit për periudhën janar-maj, në vitet 2014-2018
- Ecuria e tregut të sigurimeve 2008-2018
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2018

Zhvillime të tjera

- *Workshop* për krijimin e Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri
- Vizitë studimore pranë zyrave të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Agjencisë së Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë
- IAIS organizon Mbledhjet e Komiteteve dhe Seminarin e Përvitshëm Global

Edukimi i Konsumatorit

- Perspektiva e mbrojtjes sociale e reflektuar në mikrosigurime (pjesa e parë)

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Hungari
- Maqedoni
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Qytetarët i besojnë më shumë AMF-së në zgjidhjen e problematikave të tyre

Qytetarët i janë drejtuar gjithnjë e më shumë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për zgjidhjen e problematikave të tyre në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje. Në 6-mujorin e parë të vitit 2018 u shënua një rritje e numrit të problematikave që konsumatorët i kanë paraqitur AMF-së për zgjidhje. Deri në datën 27.06.2018 në Autoritet janë depozituar 41 ankesa për çështje të ndryshme, mbi 90% e tyre të lidhura me tregun e sigurimeve.

Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me refuzimin e pagesës së dëmshpërblimit, mosrënien dakord për vlerën e dëmshpërblimit apo pretendime për vonesa në trajtimin e praktikave nga ana e shoqërive të sigurimit.

Autoriteti ka trajtuar brenda afatave kohore të gjitha ankesat e konsumatorëve dhe po vijon me adresimin e tyre. Nga 41 ankesat e paraqitura, thuajse gjysmës i është dhënë zgjidhje përfundimtare në favor të konsumatorit dhe rreth 20% janë në proces trajtimi, të depozituara të gjitha në muajin qershor, brenda afateve. Për pjesën tjetër të ankesave të paraqitura në Autoritet, është mbyllur trajtimi dhe iu është dhënë informacioni i nevojshëm.

Nga shqyrtimi i çështjeve të ankimuara, rezulton se mosmarrëveshjet e lindura mes konsumatorit dhe shoqërive të sigurimit kanë ardhur si pasojë e mosinformimit të plotë në lidhje me kontratën e sigurimit. AMF këshillon konsumatorët të njihen me kujdes me kushtet e kontratës përpara nënshkrimit të saj dhe të kërkojnë sqarime nga shoqëritë derisa të kuptojnë plotësisht dokumentin që po nënshkruajnë dhe përfitimet prej tij.

Synimi i Autoritetit është ruajtja e një komunikimi të hapur e të drejtpërdrejtë me konsumatorët për të marrë asistencën e nevojshme për hapat që duhen ndjekur në lidhje me ankesat për të gjetur zgjidhje të problematikave të tyre.

Në 6-mujorin e parë të vitit 2018 u shënua një rritje e numrit të problematikave që konsumatorët i kanë paraqitur AMF-së për zgjidhje.


VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-qershor 2018 kapën vlerën mbi 7,707 milionë lekë, ose 3.93% më shumë se në periudhën janar-qershor 2017. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 570,783 me një rritje prej 8.33% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.50% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.43% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.07%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.82% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.18% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 570,783 me një rritje prej 8.33% krahasuar me janar-qershor 2017.




Ecuria e numrit të kontratave të sigurimit për periudhën janar-maj, në vitet 2014-2018

Tregu i sigurimeve pasqyron tendenca të qëndrueshme rritjeje nga viti në vit, jo vetëm me rritjen e volumit të primeve të shkruara bruto, por edhe të numrit të kontratave. Rritja e numrit të kontratave reflektohet më shumë në sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të tregut të sigurimeve, duke shprehur edhe një ndërgjegjësim dhe përfshirje gradualisht më të madhe të popullsisë në tregun e sigurimeve.

Duke u analizuar treguesit e periudhave janar-maj përgjatë pesë viteve 2014-2018 vërehet se ritmi i rritjes së numrit të kontratave është i lartë, sidomos në periudhat janar-maj 2017 dhe janar-maj 2018.

Në një krahasim 5-vjeçar, për periudhën janar-maj 2018, numri i kontratave arriti në 462,260 duke shënuar një rritje me rreth 26.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014.

Rritja e numrit të kontratave të sigurimit pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të AMF-së dhe shoqërive në treg për zhvillimin e mëtejshëm të tij dhe pasurimin me produkte të reja sigurimesh.



Tregu i sigurimeve ka shënuar një rritje të qëndrueshme përgjatë dhjetë viteve të fundit, ndërkohë që rritja më e ndjeshme është shënuar në katër vitet e fundit.


Ecuria e tregut të sigurimeve 2008-2018

Tregu i sigurimeve ka shënuar një rritje të qëndrueshme përgjatë dhjetë viteve të fundit, ndërkohë që rritja më e ndjeshme është shënuar në katër vitet e fundit.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga 6,561 milionë lekë që ishte në vitin 2008 arriti në 14,993 milionë lekë në vitin 2017, duke shënuar një rritje mbi dy herë.

Sigurimi i Jo-Jetës vazhdon të jetë dominues në treg dhe në këtë segment mbizotëron sigurimi i detyrueshëm motorik. Edhe sigurimi i detyrueshëm motorik ka shënuar një rritje të qëndrueshme, me pak luhatje pas vitit 2011, vit kur u liberalizua sigurimi i detyrueshëm motorik.

Grafikët paraqesin ecurinë e primeve të sigurimit për të gjithë tregun dhe primet e sigurimit të detyrueshëm motorik përgjatë një periudhe 10 vjeçare.



Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2018 u dominua në masën 90.60% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 9.40% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).


Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2018

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2018 u dominua në masën 90.60% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 9.40% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).

Përsa i përket numrit të transaksioneve, 92.51% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2018 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 57.18% dhe 29.68% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.38% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.



Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2018, ka pasur një rritje prej 437 milionë lekë ose 17.88% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Ndërkohë edhe numri i transaksioneve është rritur në masën 23.22%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2018, ka pasur ulje prej 185 milionë lekë ose 14.94% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 12.96%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 252 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-qershor 2017.

ZHVILLIME TË TJERA

Workshop për krijimin e Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datat 25 dhe 26 korrik 2018 një *workshop* me përfaqësues të shoqërive të tregut të kapitalit dhe autoritetet rregullatore në vend në lidhje me mundësinë e krijimit të Depozitarit Qendror në Shqipëri. *Workshop-i* u organizua në kuadër të projektit “Studimi i formës së ardhshme të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri”.



Gjatë zhvillimit të *workshop-it*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datat 25 dhe 26 korrik 2018 një *workshop* me përfaqësues të shoqërive të tregut të kapitalit dhe autoritetet rregullatore në vend në lidhje me mundësinë e krijimit të Depozitarit Qendror në Shqipëri.

Domosdoshmëria e krijimit të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë lidhet me realizimin e procesit të klerimit dhe shlyerjes së titujve, në shërbim të interesit publik dhe mbrojtjes së investitorit.

Projekti i nisur në maj të vitit 2018 është pjesë përbërëse e projektit kryesor që po zbaton AMF, “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike, SECO.

Vizitë studimore pranë zyrave të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë

Në datat 5-13 korrik, përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilluan një vizitë studimore pranë zyrave të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, në kuadrin e frymës së bashkëpunimit e shkëmbimit të përvojave dhe njohurive.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite studimore ishte marrja e eksperiencës nga këto vende në ngritjen dhe administrimin e sistemeve të shitjes së policave të sigurimit dhe raportimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimit.

— ◊◊◊ —
Tregu i sigurimeve në Kosovë nuk ishte i liberalizuar për sa i përket çmimit të primit, por vendosej nga Ministria e Financave në varësi të kategorive dhe klasave për çdo kategori.
— ◊◊◊ —

■ Gjatë takimeve në Bankën Qendrore të Kosovës, përfaqësuesit e BQK-së prezantuan objektivat dhe arritjet në fushën e sigurimeve. U diskutua e u shkëmbyen eksperiencia lidhur me, sistemin e shitjeve, i cili në Kosovë ishte i njëjtë për të gjithë shoqëritë e sigurimit. Kjo mënyrë e autentifikimit të agentëve ishte shumë efikase dhe e sigurt, duke shmangur kështu keqpërdorim e kodeve nga agentë të ndryshëm, apo nga persona të pa autorizuar. I gjithë sistemi dhe komunikimet me çdo pikë fundore (pikë shitje) ishte në një rrjet të mbyllur dhe të sigurt, të pa ekspozuar në internet.

Tregu i sigurimeve në Kosovë nuk ishte i liberalizuar për sa i përket çmimit të primit, por vendosej nga Ministria e Financave në varësi të kategorive dhe klasave për çdo kategori. Në Kosovë aplikohet sistemi *Bonus-Malus*, i cili ishte shumë i ngjashëm me sistemin që pritet të aplikohet në Shqipëri.

Moduli për raportimin e dosjeve të dëmit ishte online, ku shoqëritë e sigurimeve nëpërmjet përdoruesve të autorizuar raportonin të dhënat bazë të dosjeve të dëmit. Ky sistem ishte i njëjtë me Regjistrin Elektronik të Dëmeve në AMF. Sistemi i raportimit të dëmeve i jepte mundësi shoqërive të sigurimit dhe BQK të shihnin të dhënat për dosjet e tyre përkatëse, të bënin verifikimet e ndryshme, të gjeneronin raporte në formë tabelore dhe grafike të ndryshëm sipas kërkesave të tyre, duke parë edhe kohën e trajtimeve dhe pagesave.

■ Në takimet pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, përfaqësues të këtij institucioni prezantuan sistemin e shitjeve dhe dëmeve, i cili qëndronte pranë Byrosë Kombëtare të Maqedonisë, por e mbikëqyrur edhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Roli i Agjencisë ishte në krijimin e kushteve minimale në shoqëritë e sigurimit për vazhdimësinë e biznesit dhe të rikuperimit të të dhënave në rast katastrofash.

Vizita studimore në Maqedoni vijoi me një takim pranë zyrës së Byrosë Kombëtare të Maqedonisë, ku përfaqësuesit e AMF-së u njohën me sistemin e shitjeve dhe dëmeve të qëndëruar dhe nën menaxhimin e byrosë. Sistemi i shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik ishte shumë i ngjashëm me sistemin e Kosovës.

IAIS organizon Mbledhjet e Komiteteve dhe Seminarin e Përvitshëm Global

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*), organizoi mbledhjet e Komiteteve dhe Seminarin e përvitshëm global. Aktivitetet u organizuan në Moskë, 23-27 korrik 2018.

Në ditën e parë të Seminarit Global, ekspertë dhe drejtues të IAIS-it ofruan përditësime lidhur me komponentët kryesorë të axhendës së reformës pas krizës financiare, e cila po shkon drejt përfundimit. Këto përfshinë ComFrame (Kuari i Përbashkët për Mbikëqyrjen e Grupeve të Sigurimit Ndërkombëtar), duke përfshirë edhe Standardin e Kapitalit të Sigurimeve (ICS); si edhe përparimin drejt kuadrit për zbutjen e rreziqeve sistemike.

Gjatë dialogut vjetor të Komitetit Ekzekutiv me palët e interesuara, Sekretari i Përgjithshëm i IAIS, Jonathan Dixon e ndërthuri diskutimin e tij me të ardhmen, duke dhënë përditësim të procesit aktual të planifikimit strategjik dhe temave për zhvillim më tej. Një nga sesionet iu dedikua rolit të industrisë së sigurimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës.

Dita e dytë e Seminarit Global në Moskë, u fokusua tek inovacioni dhe rreziqet në zhvillimin e mëtejshëm në industrinë e sigurimeve. Në panele të ndryshme u diskutua për përdorimin e pajisjeve inovative, siç janë *regulatory sandbox* si mjete rregullues. Gjithashtu u diskutua për rrezikun e ndryshimeve të klimës dhe çfarë do të thotë kjo për industrinë e sigurimeve dhe mbikëqyrësit e sigurimeve.

Një tjetër sesion iu dedikua sigurisë kibernetike. Ekspertë nga IAIS bënë një përditësim lidhur me projekt dokumentin për "Mbikëqyrjen e siguresve lidhur me sigurinë kibernetike". Pas saj përfaqësuesi i Institutit të Stabilitetit Financiar prezantoi një dokument për një qasje më të kujdesshme në industrinë e sigurimeve, lidhur me bashkëpunimin dhe delegimin e informacionit tek ofruesit e shërbimit të IT.

AMF është anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë që prej vitit 2001. (www.iaisweb.org)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors, IAIS), organizoi mbledhjet e Komiteteve dhe Seminarin e përvitshëm global.

Perspektiva e mbrojtjes sociale e reflektuar në mikrosigurime

Aksesi në sigurinë shoqërore është një e drejtë thelbësore e njeriut. Për më tepër që siguria shoqërore dhe mbrojtja sociale njihen si pjesë përbërëse të përpjekjeve globale për të ulur varfaërinë dhe për të mbështetur zhvillimin e qendrueshëm ekonomik. Skemat e mikrosigurimeve për shtresat e marginalizuara të shoqërisë po zhvillohen vullshëm nga shumë shtete. Komisioni Evropian ka realizuar një studim në lidhje me perspektivën e mbrojtjes sociale përmes mikrosigurimit për të shpjeguar nga afër këto skema.

Dokumenti ka për autorë Christian Jacquier, Gabriele Ramm, Philippe Marcadent dhe Valérie Schmitt-Diabate

(Pjesa e parë, me shkurtime dhe redaktime)

Të ndodhur përballë mundësisë së përjashtimit nga mbrojtja sociale, komunitetet lokale po ndërmarrin iniciativa për të organizuar skema të mikrosigurimit. Mikrosigurimi ofrohet nëpërmjet një shumëllojshmërie organizatash që mbulojnë rreziqe të ndryshme ose të paparashikuara duke përfshirë shëndetin, periudhën e shtatzanisë, jetën dhe paaftësinë. Disa skema nuk janë thjesht instrumente të menaxhimit të rrezikut, por kanë potencial për të kontribuar në zgjerimin e mbrojtjes sociale për grupet e përjashtuara. Për më tepër, këto skema mund të përmirësojnë qeverisjen e ofruesve të mbrojtjes sociale (p.sh. kujdes shëndetësor) dhe të sigurojnë burimet shtesë që rrisin mbrojtjen sociale në tërësi. Kjo është veçanërisht e nevojshme aty ku shteti ka kapacitete të kufizuara financiare dhe institucionale.

Skemat e mikrosigurimit mund të jenë pjesë e sistemeve të mbrojtjes sociale, ndonëse kjo mund të ketë disa pasoja:

- Skemat e mikrosigurimit mund të marrin disa funksione të mbrojtjes sociale, të tilla si shpërndarja nëpërmjet subvencioneve të brendshme ose nëpërmjet kanalizimit të subvencioneve publike për anëtarët e tyre;
- Skemat e mikrosigurimit duhet të vlerësohen jo vetëm për aspektet teknike (p.sh. qëndrueshmërinë financiare), por edhe për kapacitetin e tyre për të arritur rezultatet e mbrojtjes sociale; duhet të merret në konsideratë edhe impakti socio-ekonomik i këtyre skemave tek anëtarët dhe jo anëtarët e tyre;
- Një treg jo i rregulluar mund të mos ofrojë një paketë efikase përfitimi për të varfërit;
- Skemat e mikrosigurimit mund të luajnë një rol të rëndësishëm në fuqizimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të tyre, që ndikon më pas në projektimin e produkteve, zgjedhjen e paketës së përfitimeve, përballimin e kostos dhe organizimin e skemave.

Mikrosigurimi ofrohet nëpërmjet një shumëllojshmërie organizatash që mbulojnë rreziqe të ndryshme ose të paparashikuara duke përfshirë shëndetin, periudhën e shtatzanisë, jetën dhe paaftësinë.

Pavarësisht përkufizimit, mbrojtja sociale është një mjet i rëndësishëm për të parandaluar varfërinë dhe për të forcuar kapacitetin e të varfërve për të dalë nga varfëria.

Gjithsesi, skemat e pavarura të mikrosigurimit, me vetëfinancim, kanë mundësi të kufizuara për të shërbyer si mekanizma të qëndrueshme dhe efikase të mbrojtjes sociale, për të arritur te segmentet e mëdha të shtresave të përjashtuara të popullsisë. Mundësitë e tyre për të zgjeruar mbrojtjen sociale rriten, kur qeveritë i përfshijnë ato në strategjitë kombëtare të mbrojtjes sociale, duke i lidhur me përbërësit e tjerë të mbrojtjes sociale për të krijuar një sistem më aktual, efikas dhe të barabartë.

Mbrojtja sociale nuk përfshin vetëm skemat publike të sigurimit shoqëror, por edhe skemat private ose jo-statutore me objektiva të ngjashme, si shoqëritë me përfitim të dyanshëm dhe skemat e pensioneve profesionale, me kusht që kontributet për këto skema të mos jenë të përcaktuara tërësisht nga forcat e tregut. Ky përkufizim i mbrojtjes sociale është një nga disa qasjet. Organizatat e tjera, të tilla si Banka Botërore, përdorin koncepte tërësore të mbrojtjes sociale ("menaxhimi i rrezikut social").

Ato përfshijnë një kategori më të gjerë të rreziqeve të paparashikuara, - çdo gjë që prek sigurinë e të ardhurave të individëve, - e cila i mbivendoset politikave të tjera të sektorit, siç është arsimi apo puna. Ky këndvështrim më i gjerë përfshin jo vetëm mekanizmat e mbrojtjes, por edhe promocionin për të rritur mundësitë ekonomike (siç janë programet e mikrofinancës, mbështetja e çmimeve ose subvencionet e mallrave). Konceptet e mbrojtjes sociale janë ende në diskutim, në programet e mbështetjes që zhvillon OECD. Pavarësisht përkufizimit, mbrojtja sociale është një mjet i rëndësishëm për të parandaluar varfërinë dhe për të forcuar kapacitetin e të varfërve për të dalë nga varfëria.

Çfarë është mikrosigurimi?

Një skemë mikrosigurimi mund të jetë një organizatë, si një shoqëri me përfitim të dyanshëm. Gjithashtu mund të jetë një grupim institucionesh që punojnë së bashku, sic mund të jenë shoqëritë e sigurimit që në bashkëpunim me institucionet e mikrofinancimit i ofrojnë sigurime të varfërve. Mikrosigurimi mund të jetë një produkt sigurimi i ofruar nga një organizatë që kryen edhe aktivitete të tjera, si një kooperativë bujqësore, e cila ofron edhe sigurime për anëtarët e saj.

Skemat e mikrosigurimit shpesh janë iniciuar nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithnjë e më shumë, këto organizata bashkëpunojnë me skemat formale të mbrojtjes sociale (p.sh. kompanitë e sigurimeve, skemat e sigurimeve shoqërore), institucionet publike (p.sh. strukturat e sektorit shëndetësor, punëve dhe çështjeve sociale), ofruesit e shërbimeve (p.sh. ofruesit e kujdesit shëndetësor). Ndonjëherë edhe pushteti lokal apo komunat mund të ofrojnë skema mikrosigurimi.

Në mënyrë që skema të ketë interes në kontekstin e mbrojtjes sociale, disa nga përfituesit e saj duhet të përjashtohen nga skemat formale të mbrotjes, veçanërisht ekonomia informale dhe punonjësit në zonat rurale dhe familjet e tyre.

Një skemë mikrosigurimi ndryshon nga programet që ofrojnë mbrojtje sociale për punëtorët e kontraktuar. Anëtarësimi nuk është i detyrueshëm (por mund të jetë automatik). Anëtarët kontribuojnë, të paktën pjesërisht në primet e nevojshme për të paguar përfitimet. Meqenëse kapaciteti i tyre për të kontribuar shpeshherë është i ulët, mbulimi i ofruar nga këto skema, (në mungesë të subvencioneve) është zakonisht i kufizuar, me një numër të vogël rreziqesh të mbulira dhe neville të ulëta përfitimesh.

Bullgari, pranë zbatimit sistemi *Bonus-Malus*

www.xprimm.com

Kompania që ka këshilluar Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare në Bullgari në lidhje me zbatimin e sistemit *Bonus-Malus* për sigurimin MTPL ka prezantuar raportin përfundimtar, me 11 skenarët e mundshëm të sistemit. Në raport përmenden edhe një numër i madh faktorësh që duhen marrë në konsideratë në ndërtimin e sistemit *Bonus-Malus*. Të gjithë skenarët bazohen në të dhënat e mbledhura nga tregu bullgar i sigurimeve, duke reflektuar specifikat e tij. Tashmë mbetet për t'u vendosur se cili nga skenarët e propozuar do të përzgjidhet për sistemin *Bonus-Malus*. Raporti i është dërguar dy dikastereve që do të jenë pjesë e vendimmarrjes finale, Ministrisë së Transporteve dhe Ministrisë së Brendshme.

Bullgaria prezanton skemën *voucher* për listimin në Bursë

www.bse-sofia.bg

Ministria e Ekonomisë dhe Bursa e Bullgarisë prezantuan skemën *voucher* në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla e të mesme për t'u listuar në tregun e rregulluar. Buxheti fillestar i skemës *voucher* për financimin e ofertave publike është rreth 2 milionë euro (3.9 milionë BGN, leva bullgare). Pasi kompanitë e para do të lëshojnë bonot e tyre dhe do të paguhen përmes kuponave, atëherë do të nisë një fazë e tyre e programit. Në bazë të skemës, financimi kryhet nëpërmjet kuponave me vlerë deri në 50 mijë leva, (rreth 25 mijë euro) dhe përfituese është Agjencia për Promovimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme. Kuponat janë të vlefshëm për një periudhë 9 mujore. Skema e re synon të mbulojë të gjitha kostot operative të ndërmarrjeve, duke stimuluar kështu daljen e tyre në një treg të rregulluar.

Hungari, moti i keq shkakton mbi 3.1 milionë euro dëme

www.xprimm.com

Kushtet ekstreme të motit në Hungari përgjatë muajit qershor sollën mbi 6 mijë raportime për dëme, në një vlerë të përgjithshme prej rreth 3.1 milionë euro (1 miliardë HUF, forinta hungareze). Rajonet jugore rezultuan më të prekurat nga moti i keq, aty ku vetëm në qytetin Peç u shënuan më shumë se 200 raste dëmsh. Përveç erërave të forta, u raportuan dëme nga përmytjet dhe nga rrufetë.

Maqedonia bashkëpunon me Turqinë për sigurimet

www.xprimm.com

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Turqi. Marrëveshja rregullon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave përse i përket mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve. Përmes marrëveshjes, të dy palët shprehën interesin për zgjerimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Turqia do të ndajë me Maqedoninë eksperiencën e saj në disa fusha të sigurimeve të cilësuara si modele të suksesshme, si në rastin e sigurimeve në bujqësi, si edhe skemën e sigurimeve për tërmetet.

BERZH asiston SME-të në Slloveni për t'u listuar në Bursë

www.ebrd.com

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Slloveni, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, si pjesë e një projekti të Agjencisë për Tregun e Letrave me Vlerë (AVTP). BERZH-i nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Bursën e Lubljanës (LJSE) që parashikon dhënien e konsulencës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kërkojnë të listohen dhe emetojnë aksione në bursë. Programi i mbështetjes nisi zbatimin në 2 korrik dhe do të zgjasë për një periudhë 2-vjeçare. Objektivi është mbështetja e SME-ve për të hyrë në tregun e kapitalit, përmes ofertave fillestare publike ose lëshimit të bonove të korporatave.

Bursat e Maqedonisë, Bullgarisë e Kroacisë në “SEE Link”

www.see-link.net

“SEE link” është një projekt i nisur nga bursat në Bullgari, Maqedoni dhe Kroaci me objektivin për të krijuar një infrastrukturë rajonale për tregtimin e aksioneve të listuara në këto tre tregje. Projekti mbështetet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Synimi i këtij bashkëpunimi është integrimi i tregjeve rajonale të aksioneve, pa synuar shkrirjen e tyre, por vetëm përmes përdorimit të teknologjisë që i jep mundësi bursave të jenë të pavarura. Për t'i dhënë gjithë projektit një kuadër formal, bursat e Bullgarisë, Maqedonisë dhe Kroacisë krijuan “SEE Link” në maj 2014, me seli në Maqedoni, aty ku të tre bursat kanë aksione të barabarta. Krijimi i këtij grupimi sjell më shumë alternativa tregtimi në bursë jo vetëm për tre shtetet pjesëmarrëse, por në përgjithësi për gjithë rajonin.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al